



Barazia gjinore në politikat nexus

Fiorela Shalsi
Konsulente për çështjet gjinore, GëP-Med

Sektorët Nexus

Sektorët Nexus përfshijnë:

- (i) Menaxhimin e burimeve ujore dhe furnizimin me ujë dhe kanalizimet
- (ii) Energjinë
- (iii) Ushqimin, Bujqësinë dhe Pyjet
- (iv) Mbrojtjen e mjedisit



NEXUS

The word "NEXUS" is rendered in a bold, dark blue, sans-serif font. Each letter is stylized with a graphic element: the 'N' has two teardrop shapes (one blue, one green) on its left side; the 'X' has a large orange lightning bolt striking through its center; the 'U' is replaced by a stylized plant stem with several yellow and orange leaves; and the 'S' has two green leaves on its right side.

UJI

Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027

Disa gjetje paraprake



- I referohet gjinisë duke theksuar rëndësinë e angazhimit të ndryshëm që duhet të këtë për të adresuar nevojat dhe prioritete e grave dhe burrave.
- I referohet Konventave kryesore që lidhen me barazinë gjinore si CEDAW dhe strategjisë kombëtare për barazinë gjinore.
- Strategjia thekson nevojën për të kryer një analizë sociale dhe gjinore mbi ndryshimet shoqërore në lidhje me kontrollin dhe përdorimin e burimeve ujore.
- Ajo gjithashtu thekson rëndësinë e shpërndarjes së barabartë të përfitimeve. Kjo është mjaft e rëndësishme pasi është mënyra e duhur për të filluar punën për të identifikuar dhe kuptuar kontekstin para ndërhyrjeve.

Vazhdim...

- Strategjia bën përpjekje për të prezantuar të dhëna të ndara sipas seksit në nisma të tilla si buxhetimi i projekteve, shpërndarja e barabartë e përfitimeve etj.
- Strategjia synon të ofrojë disa të dhëna për përfaqësimin e grave në administrimin e baseneve të ujit. Ajo specifikon se gratë zënë vend 40% në administrim duke e vlerësuar këtë si përfaqësim të barabartë. Por në strategji nuk ofrohet informacion se në cilat pozicione është ky përfaqësim, pra në nivelet e ulta, mesatare apo të larta të vendimmarrjes. Strategjia synon gjithashtu të njohë rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, por nuk propozon ndonjë veprim konkret për adresimin e kësaj pjesëmarrjeje.
- Sidoqoftë Strategjia synon të përfshijë parimet e barazisë si në vizionin ashtu edhe në misionin e strategjisë që tregon për një angazhim konkret për të mbështetur progresin drejt barazisë gjinore.



Energjia

Dokumentet e rishikuara

- Strategjia Kombëtare e energjisë 2018 – 2030
- Plan Veprimi Kombëtar për burimet e rinovueshme të energjisë 2018-2020
- Plan Veprimi Kombëtar për burimet e rinovueshme të energjisë 2015 - 2020

Disa gjetje paraprake

- Nuk ka asnjë reference të gjinisë apo çështjeve që lidhen me të në këto strategji dhe plane veprimi.
- Megjithëse Strategjia Kombëtare e Energjisë i është referuar zhvillimit të përgjithshëm shoqëror dhe përmirësimit të mirëqenies së konsumatorëve të energjisë, nuk i ka specifikuar më tej.
- Strategjia i është referuar detyrimeve ndërkombëtare si Marrëveshja e Parisit, Konventa e UNFCCC për Ndryshimin e Klimës dhe Protokollin e Kiotos. Por asnjë detaj ose referencë specifike për çështjet gjinore.



Ushqimi

Strategjia ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (ISARD) 2014 - 2020

- Ka një referencë të mirë për barazinë gjinore dhe synon identifikimin e çështjeve kryesore në lidhje me situatën, si dhe progresin drejt barazisë gjinore në sektor. Ai
- Synon të identifikojë sfidat në lidhje me mënyrën se si gratë dhe burrat ndjekin arsimin, përfshirë atë që lidhet me sektorin.
- Ofron një kapitull specifik mbi kornizën ligjore drejt të cilave strategjia është angazhuar si ligji i barazisë gjinore, ligji anti-diskriminim, etj.
- I referohet monitorimit dhe vlerësimit të ndikimit të strategjisë në barazinë gjinore duke theksuar pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave. Gjithashtu i jep rëndësi rolit të pikave fokale gjinore dhe bashkëpunimit me ministritë përkatëse
- I referohet punësimit dhe trendit në rritje të angazhimit të grave në sektor dhe krijon mundësinë për të vlerësuar politikat dhe skemat që mund të mbështesin pjesëmarrjen e barabartë



Ekosistemet

Strategjia ndërsektoriale e mjedisit (DSNM) 2015-2020

- Kjo strategji është “e verbër” në aspektin gjinor, dhe në tekstin e përgjithshëm, gjuha e përdorur është neutrale ndaj gjinisë duke i bërë të drejtat, përfshirjen, ndikimin, fuqinë, qasjen, kontrollin, si dhe përfitimet e grave, pothuajse të padukshme.
- Termat e përdorura përgjithësisht janë pothuajse të verbëra dhe në disa raste të stimulojnë përforcimin e stereotipeve tipike gjinore mbi kontrollin e burimeve dhe rolet tradicionale gjinore.

Vazhdim...

- Kështu terminologjia që referohet “tradiçës” si 1. “Sigurimi i së drejtës tradicionale të përdorimit / pronësisë së pyjeve... etj. ”), përforcon stereotipat tipikë gjinorë kur bëhet fjalë për të drejtat e pronësisë, të drejtën e përdorimit të pronësisë etj.
- Tradicionalisht, burrat kanë pasur statusin për të fituar të drejtat pronësore, pronësinë dhe kontrollin mbi burimet, ndërsa statusi i grave ndaj këtyre pronave ka qenë gjithmonë i lidhur me rolet tradicionale gjinore - gratë mund të kontribuojnë në pastrimin, mirëmbajtjen, punën dhe kujdesin në këto zona, por tradicionalisht ato nuk konsiderohen si pronare ose si persona që kanë të drejta të plota për të kontrolluar këto prona.
- Kjo gjuhë mund të përkthehet në veprimet konkrete të plan veprimit të kësaj strategjie duke rrezikuar keqpërdorimin e burimeve të dedikuara apo projekteve në kuadër të zbatimit të kësaj Strategjie.

Vazhdim...

- Produktet kryesore afatmesme apo afatgjata, ose ndarja e burimeve, nuk japin ndonjë informacion në lidhje me gratë dhe gjuha me ndjeshmëri gjinore në formulimin e tyre mungon plotësisht.
- Mungojnë dhe të dhëna specifike buxhetore sipas gjinisë për të orientuar përkthimin e tyre të mëtejshëm në programet buxhetore specifike me perspektivën e integruar gjinore “(siç kërkohet në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimin mbi përfshirjen e gjinisë në programet buxhetore).

Perspektiva gjinore

- Kur gratë dhe vajzat si dhe grupet e tjera të shoqërisë janë të fshehura (ose thjesht nënkuptohen) në një dokument politikash, është më e lehtë t'i "harrosh" gjatë zbatimit të saj.
- Pa zotërim të aseteve të tilla si toka, pylltaria dhe kullotat etj, gratë nuk mund të kenë qasje ndaj kredive, zgjerimeve dhe shërbimeve teknologjike - gjë që ndikon në aftësinë e tyre për të mbështetur familjet dhe menaxhimin e burimeve të tjera natyrore që krijojnë themelin për një sistem të qëndrueshëm prodhimi.
- Kjo si pasojë thellon dhe përjashtimin e tyre nga pjesëmarrja në projektet e zhvillimit, shërbimet dhe proceset e politikëbërjes.

Dhe integrimi gjinor në politika

- Nëse nuk i kushtojmë vëmendje të veçantë që nga fillimi për të pasqyruar qartë dhe për të mbikëqyrur perspektivën gjinore në këto dokumente politikash, do të përballemi me shumë vështirësi gjatë zbatimit të tyre por dhe në raportimin e impaktit gjatë përgatitjes së raporteve specifike në përputhje me kërkesat kombëtare dhe ndërkombëtare mbi treguesit gjinorë që masin progresin drejt barazisë gjinore.



Faleminderit

Fiorela Shalsi

Senior Gender Advisor